



REPUBLICA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANJARR/PRIZUAR: DATE RECEIVED/POSTAL IN: DATE RECHUVEN/PRIZOVAN:			
7 06. 2022			
Nënta Org. Org. Jerim. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	1049	5

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 20 qershor 2022
Nr.ref.:SP 1106/22

Për : Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm

Gjykata Kushtetuese e Kosovës



RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1.	Opinioni i auditimit	<p>Cështja A1- Vendosja e kriterëve favorizuese në specifikacionin teknik</p> <p>Sipas ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042, neni 28, pika 2, autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose</p>	<p>Rekomandimi A1</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe zyrën e prokurimit me qëllim që gjatë hartimit të specifikave teknike të mos përdoren kriterë favorizuese dhe procedurat e prokurimit të zhvillohen në pajtim me ligjin.</p>	<p>Rekomandimi A1</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm ka arritur të shtojë kontrollet e brendshme nga inicimi i kërkesave të njësive përkatëse për procedura të prokurimit ku përfshihen edhe specifikat teknike të cilat duhet të jenë në harmoni të plotë me LPP.</p>		

		<p>diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Në procedurën e prokurimit "Furnizim me aparate telefoni/smartphone", në vlerë 8,880€, KGJK me rastin e përcaktimit të specifikave në dosjen e tenderit, kishte përdorur kriteret favorizuese të cilat kishin eliminuar konkurrencën. Kjo pasi që, tek specifikacioni teknik ishin vendosur të gjitha tiparet e telefonit që e karakterizojnë brendin Iphone dhe për më tepër, tek modeli i kërkuar ishte specifikuar edhe emri i brendit përkatës. Kjo kishte ndodhur për shkak se njësi kërkuese nuk kishte marrë parasysh rregullat ligjore që ndalojnë favorizimin e brendeve apo OE-ve të caktuara.</p>		<p>Nga Njësia e Prokurimit është zbatuar dhe është implementuar prej janarit 2022. Si dëshmi janë aktivitetet e prokurimit të realizuara dhe është zbatuar kontroll në specifikat teknike të hartuara nga Njësia Kërkuese e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit.</p>	
--	--	--	--	---	--

2.	Opinioni i auditimit	<p>Çështja A2 - Mos harmonizimi i raporteve të inventarizimit me regjistrin e pasurive</p> <p>Gjetja Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo-financiare në organizatat buxhetore, neni 18 përcakton se inventarizimi i pasurisë bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo-financiare. Më tutje, sipas nenit 19, pika 4.3 dhe 4.7, Komisioni është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo-financiare, para përgatitjes së PFV-ve. Komisioni i inventarizimit në GJKK, kishte bërë inventarizimin e pasurisë në fund të vitit, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes të inventarizuar</p>	<p>Rekomandimi A2</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, të bëhet krahasimi në mes të gjendjes se inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm ka përcjell udhëzimet tek Zyrtari i Pasuri.</p> <p>Zyrtari i pasurisë do t'ju sigurojë regjistrat e pasurisë së Gjykatës komisionit për inventarizim i cili do të bëjë inventarizimin për vitin fiskal 2022. Para përfundimit të pasqyrave financiare, zyrtari i pasurisë do të bëjë verifikimin dhe krahasimin e gjendjes fillestare me gjendjen reale të siguruar nga Komisioni për</p>		
----	----------------------	--	---	---	--	--